



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr. 249/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Hasan Shala dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për shkak të vendosjes së posterave në shenjat publike të komunikacionit, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 25.10.2013, mori këtë:

**VENDIM**

**Miratohet** si e bazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 900 (nëntëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

**Arsyetim**

Me datën 11.10.2013, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga LVV, në të cilën theksohet se me datën 10.10.2013, rreth orës 12:00, anëtarë të subjektit politik PDK-së, kanë vendosur posterin e kandidatit për kryetar komune, Naim Ismajli, në shenjat publike të komunikacionit, konkretisht në tabelën Carralevë dhe Komoran, ku me këtë veprim sipas parashtruesit të ankesës është shkelur neni 33 pika b e LZP-se dhe Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike dhe Kandidatëve të tyre, neni 3 pika b.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur tre fotografi si dëshmi, për shkeljen e pretenduar.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik PDK, me datën 17.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 18.10.2013 në ora 12:00. Sipas afatit të caktuar PZAP-i, pranoi përgjigjen në ankesë nga PDK, në të cilën theksohet se pretendimet e LVV-së janë pabaza dhe të trilluara, të gjitha pretendimet e deritanishme të LVV-së janë të natyrës së njëjtë dhe se këto veprime nuk janë bërë nga ana e aktivistëve të subjektit politik PDK, mëtej theksojn në përgjigje të ankesës së nuk janë përgjegjës për këto veprime. Me propozim që PZAP-i të hedhë poshtë pretendimet e LVV-së

Bashkangjitur më përgjigjen në ankesë subjekti politik PDK, ka dërguar edhe foto për heqjen e posterav në shenjat publike.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

**Ankesa është e bazuar**

Sepse me datën 10.10.2013, rreth orës 12:00, anëtarë të subjektit politik PDK, kanë vendosur posterin e kandidatit për kryetar komune, Naim Ismajli, në shenjat publike të komunikacionit, konkretisht në tabelën Carralevë dhe Komoran ku me këtë veprim janë shkelur neni 33 pika b e LZP-se dhe Kodin e Mirësjelljes të Subjekteve Politike dhe Kandidatëve të tyre, neni 3 pika b.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

PZAP-i, mori parasysh të gjitha rrethanat si rënduese ashtu edhe rrethanat lehtësuese. Si rrethanë rënduese mori se subjektit politik PDK, ka marr pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se konsiderohet se është e njoftuar me procesin zgjedhor dhe faktin se subjekti politik në fjalë ka bërë shkelje të njëjtës natyrë në këto zgjedhje, ndërsa si rrethanë lehtësuese mori se PDK, pas marrjes së kërkesës për përgjigjes në ankesë nga PZAP-i, brenda afatit të caktuar, ka ndërmarr veprime të dukshme për evitimin e shkeljes së supozuar, duke i larguar menjëherë postrerin nga vendi ku pretendohet se ka ndodhur shkelja e supozuar.

PZAP-i duke u bazuar në arsyet e lartcekura, në provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe në pretendimet ankimore, konstatoi se subjektit politik PDK ka vendosur posterin e kandidatit për kryetar komune, Naim Ismajli, në shenjat publike të komunikacionit, konkretisht në tabelën Carralevë dhe Komoran, e cila shkelje është në kundërshtim me nenin 4 paragrafi 1 pika "b" të Rregullës Zgjedhore 11/2013 dhe nenit 33 pika b) të LZP-së, andaj në kuptim të nenit 120 paragrafi 1 pika c), si dhe nenit 115.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në Prishtinë**

Anr. 249/2013 më datën 25.10.2013.

**Kryesuesi i Panelit  
Muhamet Rexha**

Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*